

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.91/2017

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti i Krimeve të Renda (në Objektin e gjykatës në Veri Mitrovicë), Kryetari i trupit gjykues Avni Mehmeti, me anëtarët e trupit gjykues –gjyqtaret; Dragica Jakovljevic dhe Branka Semenov, me procesmbajtësen Hasnije Muhaxheri, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDAKTUAR] për shkak të veprës penale; Keqpërdorimi i të drejtës së votimit nga nenin 216 par 1 pika 1.2 të KPRK-së, sipas akuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.I.nr:149/2014, dt.04.07.2017. Pas mbajtjes dhe përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, në prezencën e palëve; prokurorit të shtetit në PTH në Mitrovicë Njazi Rexha, të pandehuri [REDAKTUAR] mbrojtësit të tij av. Shefqet Ibrahim, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, publik të regjistruar në procesverbal, në prezencën e të pandehurit dhe mbrojtësit të tij e në mungesën e prokurorit të shtetit në PTH në Mitrovicë Njazi Rexha, me dt.10.01.2018, e ka shpallur publikisht aktgjykimin, ndërsa me dt.29.01.2018, gjykata e ka përpiluar me shkrim këtë:

AKTGJYKIM

Kundër të pandehurit:

[REDAKTUAR] nga i ati [REDAKTUAR] e ëma [REDAKTUAR] e gjinisë [REDAKTUAR] i lindur me 18.12.1974 në fshatin [REDAKTUAR] komuna e [REDAKTUAR] me vendbanim në [REDAKTUAR] rr. [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] p.n., shtetas i Republikës së Kosovës, shqiptar, me nr. personal [REDAKTUAR], me profesion kuzhinier, i martuar, baba i tre fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, i punësuar si kuzhinier në kompaninë private [REDAKTUAR] [REDAKTUAR], ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, i njëjti:

SHPALLET FAJTOR

Sepse:

Me dt.03.11.2013, në zgjedhjet lokale në Kosovë, në shkollën e mesme teknike “Anton Qeta” në Skenderaj, në vendvotimin nr. [REDAKTUAR] ka votuar si votues me kusht edhe pse me parë të njëjtën ditë e në kundërshtim me ligjin për zgjedhjet lokale, ka votuar edhe si votues i rregullt në shkollën fillore në fshatin Turiqec -- Skenderaj.

-Me këtë ka kryer veprën penale; **Keqpërdorimi i të drejtës së votimit nga neni 216 par.1 pika 1.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-ës).**

Andaj gjykata në mbështetje të nenit 2 nenit 7 , 8, 9, 10, 17, 21, 45, 73, e nenit 216 të KPRK-ës, e lidhur me nenet 365, 366 të KPP-ës, të pandehurit Shefqet Sahiti, I

SHQIPTON DËNIM ME KUSHT

Ku i përcakton:

- I. **DENIM ME BURGIM** në kohëzgjatje prej / 6 / gjashtë / muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale të natyrës së njëjte apo natyrës me të rend, brenda një afati kohor prej /1/ një viti, nga koha e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën ky dënim ekzekutohet.
- II. **OBLIGOHET** i pandehuri [REDAKTUAR] të kompensoj shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 30 euro dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 20 euro, të cilat obligohet që t'i paguaj në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- III. Kërkesë pasurore juridike nuk pati.



Arsyetim

Rrjedha e procedurës penale:

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, ka ngritur akuzë ndaj të pandehurit PP.I.nr:149/2014, dt.04.07.2017, ndaj të pandehurit [REDAKTUAR] për shkak të veprës penale: Keqpërdorimi i të drejtës së votimit nga neni 216 par 1 pika 1.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Gjykata, për këtë lëndë penale në kuadër të kompetencës lëndore e territoriale, ka caktuar dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me dt.04.12.2017, në të cilin kanë qenë të pranishëm prokurori i shtetit në PTH-Mitrovicë Njazi Rexha, i pandehuri [REDAKTUAR] dhe mbrojtësi i tij av.Shefqet Ibrahimimi.

I pandehuri [REDAKTUAR], në shqyrtimin fillestar nuk e ka papranuar fajësinë.

Gjykata, nuk e ka mbajtur seancën e shqyrtimit të dytë, por palëve i 'u ka japë mundësi që të paraqesin kundërshtime kundër provave dhe akuzës. I pandehuri dhe mbrojtësi i tij brenda afatit ligjor nuk ka parashtruar kundërshtim në aktakuzë e as lidhur me provat.

Me 10 janar 2018, është mbajtur seanca e shqyrtimit gjyqësor në prezencën e gjitha palëve. I pandehuri [REDAKTUAR] në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale për të cilën ishte akuzuar- Keqpërdorimi i të drejtës së votimit nga neni 216 par.1 pika 1.2 të KPRK-ës.

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i pandehuri [REDAKTUAR] e në mbështetje të nenit 248 të Kodit të Procedurës Penale(KPP-ës), në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurin. Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit [REDAKTUAR] mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykate si: zarrfin e fletëvotimit me kushte në vendvotimin nr. [REDAKTUAR] në Skenderaj, ku shihet se ka votuar [REDAKTUAR] lista e votuesve me kushte në vendvotimin nr. [REDAKTUAR] në Skenderaj, ku shihet se [REDAKTUAR] ka nënshkruar si votues, si dhe lista e votuesve të rregullt nr: [REDAKTUAR] të cilën e ka nënshkruar [REDAKTUAR]. Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë e tyre dhe pranimin të fajësisë, konsiderojmë se për tej çdo dyshimi është vërtetuar se i pandehuri [REDAKTUAR], ka kryer veprën penale: Keqpërdorimi i të drejtës së votimit nga neni 216 par.1 pika 1.2 të KPRK-ës.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare, se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, duke i'u tërhequr vërejtja të pandehurit se pas pranimin të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri [REDAKTUAR].

Gjykata, nga pranimi i fajësisë se të pandehurit [REDAKTUAR] dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale: Keqpërdorimi i të drejtës së votimit nga neni 216 par.1 pika 1.2 te KPRK-ës.



Caktimi i llojit dhe lartësisë së dënimit:


Gjykata, lidhur caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, për të pandehurin [REDAKTUAR] ka vlerësuar rrethanat për matjen e dënimit ne mbështetje të nenit 73 të KPK-ës, e si rrethanë rënduese gjykata ka vlerësuar, dashjen e të pandehurit te kjo vepër penale, shkallen e përgjegjësisë penale të tij, kontributin esencial në këtë vepër penale, faktin se këto kjo natyrë e veprave penale kane qenë shumë të shprehura në Kosovë, faktin se këto vepra penale kanë ndikim negative tek qytetaret e Kosovës, krijojnë mosbesim në institucionet e shtetit, sepse siç dihet përmes rezultatit të votimit zgjedhën përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës. Ndërsa si rrethanë lehtësuese gjykata ka vlerësuar se, i pandehuri ka pranuar fajësinë në tërësi për veprën penale, faktin se i njëjti ka shprehe keqardhje dhe është pënuar për ndodhjen e rastit, duke premtuar se në të ardhmë nuk do të përsërisë sjelljet e njëjta, sjellja korrekte e të pandehurit në gjykatë, ne raport me gjykatë dhe palët, faktin se i pandehuri për herë të para ka ra ndesh me ligjin, ndërsa ndaj tij nuk zhvillohet ndonjë procedurë tjetër penale (kjo vërtetohet nga aktakuza ku ekziston një konstatim i tillë). Gjykata, ka vërtetuar se i pandehuri e kishte kryer këtë vepër penale qe është fajtor, mirëpo kjo gjykatë ka vërtetuar se tek kjo vepër penale ka munguar pasoja nga vepra penale, sepse nga kallëzimi penal i paraqitur ndaj të pandehurit nga Komisionit Qendror i Zgjedhjeve në Kosovë, vërtetohet se vota me kushte e të pandehurit [REDAKTUAR] është anuluar dhe nuk është numëruar, çka nënkupton se vota e tij me kusht nuk ka pasqyruar rezultatit e zgjedhjeve në Kosovë. Gjykata, në veprimet e të pandehurit nuk ka gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht rënduese, gjykata vlerëson se një dënim i tillë i shqiptuar ndaj të akuzuarit është adekuat dhe ne jemi të bindur se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i cili parashihet me ligj. Gjykata, e ka pa si të arsyeshme qe dënimin në këtë rast ta kushtëzoje nga arsyet e cekuar si më lartë.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendimin e mori në bazë të nenit 450 të KPP-së.

Gjykata nga arsyet e cekura si më lartë e bazuar në nenin 365 të KPP-ës, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti për Krime të Rënda
P.nr.91/2017 i dt.29.01.2018

Procesmbajtësja:
Hashije Muhaxheri



Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari:
Avni Mehmeti



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa, i drejtohet gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme për gjykatën.



Handwritten signature and the number 3.